



# ANALIZË TEMATIKE: REAGIMI GLOBAL EKONOMIK KARSHI COVID19

## RRETH ANALIZËS TEMATIKE

Analiza Tematike është një publikim i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) e cila synon të sjellë vëmendje tek politikat e ndryshme ekonomike dhe të përshkruajë sfidat për zhvillimin e politikave të tilla, në mënyrë që të hapë rrugën për adresimin e tyre. Ky botim vë në fokusin Reagimin Ekonomik Botëror ndaj pandemisë COVID-19.

*Ju lutemi keni parasysh se kjo analizë pasqyron perspektivën e Marsit 2020 dhe meqenëse virusi po evoluon shpejt, disa informacione mund të jenë të vjetruara.*

*Shënim: Kjo analizë është përpiluar fillimisht në gjuhën angleze.*

## GJENDJA DHE NDIKIMI EKONOMIK I COVID-19 DERI SOT

Përhapja e COVID-19, origjina e së cilit është në Wuhan të Kinës, shfaqet si një sfidë e paprecedentë për gjithë botën moderne, sfidë kjo e cila ka detyruar mbylljen e shkollave, bizneseve, jetën shoqërore dhe ka kufizuar lirinë e lëvizjes - të gjitha këto në përpjekje për të frenuar përhapjen e virusit dhe të parandalohet përshkallëzimi i krizës shëndetësore. Izolimi në shtëpi

ka ndikuar negativisht tek shumë industri duke ulur kështu shkallën e prodhimit dhe distribuimit të produkteve, duke shkaktuar rënie në qarkullim dhe duke prishur zinxhirin e furnizimit në tregjet botërore.




Figura 1. Shënim: Perspektivat e rritjes së BPV-së. Burimi: OBZHK, Baza e të dhënave mbi perspektiven

Ekonomistët po pohojnë se COVID-19 ka potencial që të ketë ndikim, nëse jo më të keq, të ngjashëm si kriza botërore financiare e vitit 2008. Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE), këtë vit rritja e Bruto Produktit Vendor (BPV) do të bjerë në 2.4% (fig.1), derisa mbyllja e bizneseve gjatë krizës mund të rezultojë në 15% ose më shumë në disa biznese të caktuara (fig.2).<sup>1,2</sup> Megjithëse thirrjet e shpejta për distancim social kanë ndikuar që njerëzit të humbasin vendet e tyre të punës, vetë-karantinohen, të blejnë produkte si shkak i panikut, dhe grumbullojnë rezerva ushqimore, bizneset po bëjnë thirrje për nevojën e qarkullimit të parave në mënyrë që të operojnë, të shmangin falimentimin dhe largimet e mundshme të punëtorëve. Me atë që u tha, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) tashmë ka deklaruar se bota është në recension.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> OBZHK, Vlerësimi i Përkohshëm Ekonomik, Koronavirusi: Ekonomia botërore në rrezik, 2020, <https://www.oecd.org/berlin/publikationen/Interim-Economic-Assessment-2-Mars-2020.pdf>

<sup>2</sup> OBZHK Vlerësimi i ndikimit fillestar të masave të kontrollit ndaj COVID-19 në aktivitetin ekonomik, 2020, <https://www.oecd.org/coronavirus/en/>

<sup>3</sup> FMN, Deklaratë rreth COVID-19, 2020 Mars, 2020, <https://www.imf.org/en/News/Articles/2020/03/27/pr2014-joint-statement-by-the-chair-of-imfc-and-the-managing-director-of-the-imf>

Megjithëse madhësia e ndikimit ekonomik mbetet ende e panjohur dhe e pasigurt, trazirat botërore që kjo pandemi ka shkaktuar kanë shtyrë udhëheqësit e vendit të përgatisin stimuj fiskal në mënyrë që të zbusin ndikimin e rënies ekonomike dhe të ndihmojnë vendet e tyre të rikuperohen shpejtë, pasi të mbarojë pandemia. Se a do të jenë në gjendje ta bëjnë një gjë të tillë, varet se si politikëbërësit reagojnë ndaj krizës. Vendet e zhvilluara tashmë kanë filluar të hartojnë politika ekonomike në mbështetje të bizneseve dhe punëtorëve duke injektuar kështu pako stimuluese, ndërsa organet e BE-së dhe organizatat ndërkombëtare janë zotuar të ndërmarrin veprime të koordinuara në mënyrë që të lehtësojnë barrën financiare të ekonomive në zhvillim dhe ekonomike të zhvilluara, barrë kjo e shkaktuar nga koronavirusi.




Figura 2. Shënim: Mbyllja e bizneseve gjatë krizës së COVID-19. Burimi: Llogaritë Kombëtare Vjetore të OBZHE-së dhe llogaritjet e OBZHE -së.

Oda Amerikane në Kosovë është duke përcjellur me vëmendje planet ekonomike botërore ndaj krizës. Për këtë edicion, Oda Amerikane do prezantoj masat ekonomike që qeveritë e SHBA-së, Mbretërisë së Bashkuar, Kanadasë, Gjermanisë, Zvicrës dhe Francës, kanë ndërmarrë kundër COVID-19 deri më sot.

## PLANI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR SHPËTIM EKONOMIK

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë hartuar dhe nënshkruar një pako masive ekonomike, si përgjigje ndaj pandemisë COVID-19, shumë kjo që kap vlerën totale prej 2 trilion dollarësh.

Projektligji me vlerën më të madhe në historinë amerikane që u shndërrua në ligj më 27 mars 2020, i

njohur gjithashtu si COVID-19 Akti për Ndhimë, Lehtësim dhe Siguri Ekonomike (ANLSEK) synon të kufizojë dëmet ekonomike dhe shëndetësore të qytetarëve dhe komunitetit të biznesit amerikanë, shkaktuar nga pandemia .

Komponentët e pakos së ANLSEK që mbulojnë pagesën e stimujve fiskal janë të gjera në aspektin e fushëveprimit, megjithatë, një nga komponentët kryesor të kësaj pako, është padyshim Stabilizimi Ekonomik dhe Ndhimja për sektorët që janë të ndikuar rëndë nga pandemia.

Përballë pasojave ekonomike dhe krizës së mundshme kreditore, Qeveria Amerikane ka ndërmarrë hapa për të mbrojtur komunitetin e biznesit duke ofruar kështu ndihma të shumëfishta kreditore.

## BANKIMI DHE FINANCAT

Programi Kredi për Mbrojtje të Pagave, që kap shumën prej 349 miliardë dollarë është një nga programet kryesore. Ky program do të jetë në dispozicion nga 15 shkurti 2020 deri më 30 qershor 2020.<sup>4</sup>

Bizneset të cilat janë duke hasur vështirësi në veprimtaritë e tyre gjatë kohës së koronavirusit, mund të marrin para hua për qëllime të ndryshme, ku përfshihen; kostot e pagave, kompensimin e punonjësve, detyrimet ndaj interesit të hipotekës dhe qiranë, ndër të tjera.<sup>5</sup> Plani gjithëpërfshirës ekonomik ANLSEK akumulon 500 miliardë dollarë për ndihmë ndaj bizneseve, shteteve dhe komunave, ndërsa 454 miliardë dollarët e mbetur mund të përdoren për të mbështetur huadhëniet për biznese, shtetet dhe komunat që janë të kualifikuara të përfitojnë nga programi në fjalë.

Përmes Aktit të ANLSEK, Sekretari i Thesarit ka legjitimitetin të garantoj për hua për shtetet, komunat dhe bizneset e kualifikuara.<sup>6</sup> Në mënyrë që të ju ndihmoj bizneseve të vogla dhe punëtorëve, veprimtaria e të cilëve është ndalur nga COVID-19, dhe për të parandaluar një recesion të thellë, SHBA ka përgatitur program të veçantë, që njihet si Hua për

<sup>4</sup> Frank S. Murray Jr Jared B. Rifis Leah R. Imbrogno Jamie N. Class Matthew E. Sierawski Julia Di Vito Kaitlyn M. Foley Michael A. Donadio, Foley & Lardner LLP, 27, Mars, 2020, <https://www.foley.com/en/insights/publications/2020/03/coronavirus-cares-act-enacted-into-law>

<sup>5</sup> Ibid

<sup>6</sup> Ibid

Biznese të Vogla. Shteti Amerikan u zotua fuqishëm që do ta zgjeroj kualifikimet për Aktin e ANLSEK, për huamarrësit dhe shumë e huave që do jenë të qasshme përmes Administratës për Biznese të Vogla Amerikane. Këto kredi të fazës emergjente kanë garanci 100% gjatë vitit 2020 dhe bizneset mund të shtyjnë pagesat e kredisë deri në një vit.<sup>7</sup>

## PËRKRAHJA NDAJ PUNËSIMIT

Punëtorët e kualifikuar të SHBA-së që janë të papunë, pjesërisht të papunë ose që ushtrojnë profesione të lira, e që kanë vështirësi financiare si shkak i largimit apo pezullimit nga puna, ose thjesht që nuk janë duke punuar si rezultat i COVID-19, do të marrin si kompensim mesataren e pagës së tyre, për 26-39 javë radhazi, varësisht nga rregullat e shteteve përkatëse. Sipas pakos së shpëtimit të Aktit ANLSEK, shteti do të mbulojë një pagesë shtesë prej 600 dollar deri më 31 korrik, 2020.

## PAGESAT E DETYRIMEVE TATIMORE

SHBA ka shtyrë pagesat e tatimeve nga 15 prilli deri më 15 korrik 2020, pa imponuar norma interesi ose gjoba.

Ndër të tjera, Akti gjithashtu përfshin kredi të rimbursueshme për tatimin në paga, gjë që lejon punëdhënësit të shtyjnë pagesat e tatimeve të pagave për kontributet e Sigurimeve Sociale, ku gjysma e pagesës duhet të bëhet deri më 31 dhjetor 2021, dhe pjesa tjetër deri më 31 dhjetor 2022.<sup>8</sup>

## PLANI I MBRETËRISË SË BASHKUARA PËR SHPËTIM EKONOMIK

Në përpjekje për të shmangur recesionin, lehtësuar problemet financiare dhe për të zbutur barrën e përgjithshme ekonomike të komunitetit të biznesit dhe punëtorëve, barrë kjo e shkaktuar nga përhapja e COVID-19, Mbretëria e Bashkuar ka prezantuar fondet që të i mbështesë drejtpërdrejt qytetarët e saj dhe komunitetin e biznesit.

<sup>7</sup> Jim Chappelw, COVID-19 Akti për Ndihmë, Lehtësim dhe Siguri Ekonomike (ANLSEK), Mars, 2020, <https://www.investopedia.com/coronavirus-aid-relief-and-economic-security-cares-act-4800707>

<sup>8</sup> Fondacioni për Taksa, Planet për Lehtësim Ekonomik gjatë shpërthimit të COVID-19, Mars, 2020, <https://taxfoundation.org/coronavirus-country-by-country-responses/>

## PËRKRAHJA NDAJ PUNËSIMIT

Pakoja e masave të marra është e gjerë dhe përmban programe të ndryshme, një prej tyre është Skema për Ruajtjen e Punës. Përmes këtij programi, qeveria synon të subvencionojë 80% të pagave të punëtorëve për tre muajt e ardhshëm, me vlerë 2.500 funte në muaj, megjithëse, vetëm ata punonjës që përdorin sistemin PAYE (Paguaj Ashtu Siç Fiton) - metodë kjo për të paguar taksa për të ardhurat dhe skemën e kontributeve, janë të kualifikuar për këtë program.<sup>9</sup>

E njëjta gjë vlen edhe për të vetë-punësuarit, përveç se për ta është projektuar një program tjetër i njohur si Skema për Mbështetjen e të Ardhurave për të Vetë-Punësuarit. Qeveria gjithashtu do të mbështesë bizneset që po paguajnë pushime mjekësore për punonjësit e tyre, të cilët janë sëmure si shkak i COVID-19. Sidoqoftë, është akoma e diskutueshme nëse skema për të vetë-punësuarit do të zbatohet para qershorit 2020.

## BANKIMI DHE FINANCAT

Një tjetër masë mbështetëse është Skema e Kredisë për Ndërprerjen e Aktivitetit Biznesor, e cila u jep mundësi bizneseve të marrin kredi. Kjo është një skemë e përkohshme e kredisë, e cila jepet nga Banka Britanike e Biznesit, për të mbështetur NVM-të duke u dhënë kështu atyre mundësinë që të marrin kredi bankare dhe të mbi tërheqin para. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar do t'u jap huadhënësve garanci kreditore deri më 80% për secilën kredi dhe do të paguajë interesin kreditor për 12 muaj.<sup>10</sup> Përmes kësaj skeme do të ofrohet kredi deri në 5 milion funte për NVM-të përmes Bankës Britanike të Biznesit.<sup>11</sup> Programi i njohur si Lehtësirat e Financimit të Korporatave do të mbështesë korporatat e mëdha, që ka për qëllim t'i ndihmoj atyre të paguajnë detyrimet afatshkurta.

## PAGESAT E DETYRIMEVE TATIMORE

<sup>9</sup> Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, COVID-19: Mbështetje për bizneset, Mars, 2020, <https://www.gov.uk/government/publications/guidance-to-employers-and-businesses-about-covid-19/covid-19-support-for-businesses>

<sup>10</sup> Ibid.

<sup>11</sup> Ibid.

Në aspektin e tatimeve, Mbretëria e Bashkuar gjithashtu ka shtyrë pagesat e TVSH-së dhe të Tatimit mbi të Ardhurat deri më 31 janar 2021, duke lejuar kështu bizneset të zgjerojnë e organizojnë aktivitetet e tyre.<sup>12</sup>

## PLANI I KANADASË PËR SHPËTIM EKONOMIK

Si pasojë e kërcënimit nga koronavirusi, Qeveria e Kanadasë ka ndërmarrë veprime për të mbështetur bizneset kanadeze dhe punëtorët. Për të ndihmuar komunitetin e biznesit dhe punëtorët të përballen me këto kohë të vështira, qeveria ka prezantuar planin emergjent ekonomik që kap shumën prej 82 miliardë dollarë.<sup>13</sup>

### PËRKRAHJA NDAJ PUNËSIMIT

Shuma e lartë cekur synon të ruaj vendet e punës dhe t'i ofrojë komunitetit të biznesit mundësinë që të operoj me sukses, duke shmangur kështu falimentimin. Ndërsa subvencionet për paga për punëtorët e bizneseve të vogla do të jetë deri në 75%. Ky kompensim do të ofrohet për 3 muajt e ardhshëm.

### BANKIMI DHE FINANCAT

Për të stabilizuar më tej ekonominë, Kanadaja do të rrisë disponueshmërinë e kredisë për bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha. Programi i ashtuquajtur Programi për Disponueshmëri të Kredisë Biznesore do të sigurojë 65 miliardë dollarë ndihmë shtesë për bizneset që kanë ndërprerje në qarkullimin e parave, ky program do të zbatohet nga Banka Kanadeze për Zhvillimin e Biznesit dhe Zhvillimi i Eksportit në Kanada.<sup>14</sup>

Në mënyrë që të ofroj një mbështetje më të madhe kompanive të vogla, qeveria u zotua për krijimin e një programi tjetër të quajtur Llogaria Biznesore për Emergjencja në Kanada, me vlerë 25 miliardë dollarë kanadeze, e kjo do të sigurojë kredi për bizneset dhe kompanitë jofitimprurëse deri në 40,000 dollarë

kanadez me zero interes.<sup>15</sup> Sidoqoftë, vetëm kompanitë që në vitin 2019 kanë paguar në total nga 50,000 deri në 1 milion dollar kanadez për paga, kualifikohen për këtë program.<sup>16</sup> Për më tepër, NVM-të do të përfitojnë edhe nga një iniciativë tjetër, Garancia e Re Kreditore për NVM-të, e cila synon të mbështesë bizneset që marrin kredi më lehtë. Programi do të sigurojë kredi deri në 6.25 milion dollar kanadez.<sup>17</sup>

### PAGESAT E DETYRIMEVE TATIMORE

Ndihma tjetër financiare që u ofrua menjëherë nga qeveria e Kanadasë është shtyrja e afatit të për pagesa të tatimeve në të ardhura deri më datën 31 gusht, 2020.

Ndërsa, për Tatimin e Mallrave dhe Shërbimeve, Tatimin në Shtije dhe detyrimet doganore, afati është caktuar më 30 qershor, 2020.<sup>18</sup> Asnjë normë interesi ose formë e gjobës nuk do të vendoset gjatë kësaj periudhe, gjë që siguron qarkullim të mjaftueshme të parave.

## PLANI I GJERMANISË PËR SHPËTIM EKONOMIK

Të vetëdijshëm për përshkallëzimin e mundshëm të krizës ekonomike shkaktuar nga COVID-19, Qeveria Federale e Gjermanisë veprimi shpejtë në prezantimin e një pako të mirë stimuluese, pako kjo e dizajnuar që të ndihmoj bizneset dhe punëtorët gjermanë të kalojnë këto kohë të vështira dhe të rrisin aktivitetin e tyre ekonomik në periudhën pas pandemisë.

### BANKIMI DHE FINANCAT

Gjermania ka prezantuar një masë jo-konvencionale për të mbështetur ekonominë e saj – kredi emergjente pa limit – për ato biznese veprimtaria e të cilave është goditur nga koronavirusi.

Kreditë do të i jepen bankës Gjermane kombëtare për zhvillim e njohur si Kreditanstalt für Wiederaufbau

[finance/economic-response-plan/covid19-businesses.html#business\\_credit\\_availability\\_program](https://www.bundesbank.de/finance/economic-response-plan/covid19-businesses.html#business_credit_availability_program)

<sup>15</sup> Ibid.

<sup>16</sup> Ibid.

<sup>17</sup> Ibid.

<sup>18</sup> Ibid.

<sup>12</sup> Ibid.

<sup>13</sup> Lajmet nga CBC, Trudeau prezantoi 82 miliardë dollar kanadez për pakon emergjente ndaj COVID-19 për bizneset dhe Mars, 2020, <https://www.cbc.ca/news/politics/economic-aid-package-coronavirus-1.5501037>

<sup>14</sup> Qeveria e Kanadasë, Ndihmë për Bizneset, Prill, 2020, <https://www.canada.ca/en/department->

(KfW), me këtë Gjermania bëhet vendi i vetëm në Evropë, dhe ndoshta edhe në botë që zbaton një politikë aq të spikatur.

Për më tepër, qeveria gjermane ka njoftuar se limiti i garancisë kreditore për bankat që ofrojnë garanci, i njohur gjithashtu si Bürgschaftsbanken, do të dyfishohet në 2.5 milion euro, ndërsa Programi i Madh për Garanci që më parë është shfrytëzuar për bizneset që operojnë në rajone të varfëra, tani do të shërbej edhe për bizneset e rajoneve të tjera.<sup>19</sup>

## **PËRKRAHJA NDAJ PUNËSIMIT**

Në përpjekje për të ruajtur vendet e punës dhe ekonominë, shteti do të sigurojë që stabilizatorët automatikë të hynë në funksion të plotë. Përmes masave të zbatuara më parë, Gjermania do të sigurojë që punëtorët do të kompensohen për orët e reduktuara të punës. Këto masa gjithashtu do të jenë në dispozicion të punonjësve të përkohshëm dhe të agjencisë. Zyra Federale e Punës do të mbulojë kontributet e plota të sigurimeve për punëtorët.<sup>20</sup>

## **PAGESAT E DETYRIMEVE TATIMORE**

Për të mposhtur më tej sfidat e dala nga COVID-19 dhe për të zvogëluar pakënaqësitë ekonomike të bizneseve dhe punëtorëve, qeveria e Gjermanisë do të ofroj ndihmë për likuiditetin tatimor, e kjo do i jepet ndërmarrjeve të goditura nga virusi. Pagesat e detyrimeve tatimore do të shtyhen deri më 31 dhjetor 2020, duke siguruar kështu likuiditetin të mjaftueshëm për kompanitë, ndërsa masat përforcuese nuk do të zbatohen para 31 dhjetorit 2020.<sup>21</sup>

## **PLANI I ZVICRËS PËR SHPËTIM EKONOMIK**

Për të ndihmuar bizneset dhe punëtorët të lehtësojnë barrën e shkaktuar nga shpërthimi i koronavirusit,

<sup>19</sup> Qeveria e Gjermanisë, Ministria e Financave të Gjermanisë Federale, Mburoja Mbrojtëse ndaj Koronavirusit, Mars 2020, <https://www.bundesfinanzministerium.de/Content/EN/Staendardartikel/Topics/Public-Finances/Articles/2020-03-17-corona-protective-shield.html>

<sup>20</sup> Ibid.

<sup>21</sup> Ibid.

<sup>22</sup> Fondacioni për Taksa, Planet për Lehtësim Ekonomik gjatë shpërthimit të COVID-19, Mars, 2020, <https://taxfoundation.org/coronavirus-country-by-country-responses/>

Zvicra ka ndërmarrë masa modeste, krahasuar me ekonominë e tjera të zhvilluara. Qeveria zbuloi një pako stimuluese me vlerë 42 miliardë franga.<sup>22</sup>

## **BANKIMI DHE FINANCAT**

Këshilli Federal do të sigurojë deri në 580 milion franga për banka që garantojnë kredi, në mënyrë që të ju ndihmoj Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) më vështirësi financiare të operojnë gjatë kohës së pandemisë, ndërsa 10 milion franga shtesë do të ndahen për mbulimin e shpenzimeve administrative për organizatat/bankat që garantojnë kredi, shumë kjo që do të ju ndihmoj atyre të operojnë gjatë kohës së pandemisë.<sup>23</sup> Ndërkaq, ndihma financiare prej 32 miliardë franga, e cila u prezantua më vonë, ka për qëllim të ndihmojë drejtpërdrejt kompanitë që të operojnë gjatë kohës së COVID-19.

## **PËRKRAHJA NDAJ PUNËSIMIT**

Sa i përket pagave, Zvicra fillimisht ka ndarë një fond prej 10 miliardë franga, i cili kryesisht synon të mbulojë pagat e punonjësve, veprimtaria e të cilit është ndikuar nga COVID-19.<sup>24</sup> Zvicra gjithashtu do të kompensojë pagat e të vetë-punësuarve, punëtorëve që ushtrojnë profesione të lira dhe të atyre prindërve që janë të detyruar të qëndrojnë në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijët. Ndërsa, ato biznese që janë më të goditurat nga koronavirusi, do të fitojnë deri në 1 miliard franga ndihmë financiare, me qëllim që t'i ndihmoj ata në lidhjen e likuiditetit të ndihmës financiare.<sup>25</sup>

## **PAGESAT E DETYRIMEVE TATIMORE**

Stimujt fiskal në formën e shtyrjes së pagesave të tatimeve janë marrë parasysh edhe në Zvicër. Bizneseve zvicerane do t'u ofrohen pushime për pagesë të TVSH-së deri në fund të vitit 2020, dhe mundësi për shtyrje të pagesave të kontributeve të sigurimeve sociale.<sup>26</sup> Megjithatë, ende mbetet e

<sup>23</sup> Ibid.

<sup>24</sup> Qeveria Zvicerane, Këshilli Federal, Masat kundër Koronavirusit, Mars, 2020, <https://www.admin.ch/gov/de/start/dokumentation/medienmitteilungen/bundesrat.msg-id-78437.html>

<sup>25</sup> Ibid.

<sup>26</sup> Fondacioni për Taksa, Planet për Lehtësim Ekonomik gjatë shpërthimit të COVID-19, Mars, 2020, <https://taxfoundation.org/coronavirus-country-by-country-responses/>

paqartë se si do të ndahet pjesa tjetër e parave mes kompanive.

## PLANI I FRANCËS PËR SHPËTIM EKONOMIK

Në përpjekje që të ju ndihmoj kompanive franceze të kenë qarkullim dhe të mos hasin vështirësi, Franca ka ndërmarrë masa të menjëhershme për të mbështetur kompanitë në fjalë duke prezantuar një skemë stimuluese mjaftë të qëlluar. Shteti ka ndarë 345 miliard euro që të ruaj ekonominë.

### BANKIMI DHE FINANCAT

Meqenëse pasiguria ekonomike po vazhdon të përhapet me të madhe, kompanitë po kërkojnë mbështetje të posaçme nga shteti i tyre. Prandaj, në total një shumë prej 300 miliardë eurosh do të përdoret si garanci kreditore, kryesisht për NVM-të, gjë që do të ju mundësoj kompanive të sigurojnë fonde të nevojshëm për vazhdimin e veprimtarive të tyre dhe t'i stimuloj ato të mbajnë punonjësit e tyre.<sup>27</sup>

Ndërmarrjet e vogla dhe punëtorët që ushtrojnë profesione të lira që kanë qarkullim më të vogël se 1 milion euro dhe kanë pësuar humbje në qarkullim prej më shumë se 70% gjatë muajit mars 2020, do të përfitojnë nga i ashtuquajti Fondi i Solidaritetit, i cili mbështetet nga shteti, rajonet dhe ndërmarrje e mëdha.

### PËRKRAHJA NDAJ PUNËSIMIT

Ngjashëm me SHBA-të, Gjermaninë dhe vendet e tjera të zhvilluara, Franca u zotua të kompensojë pagat e punonjësve. Në mënyrë që të ju ndihmoj punëtorëve të përballen me këtë krizë, qeveria do të kompensojë deri në 70% të pagës, deri në vlerën 6,927 euro në muaj, ndërsa për ata që paguhen në pagë minimale ose më pak se aq, shteti do të kompensojë deri më 100% të pagës - masë kjo mjaftë premtuese.<sup>28</sup>

### PAGESAT E DETYRIMEVE TATIMORE

<sup>27</sup> Gabe Aleprt, COVID-19 Akti për Ndhimë, Lehtësim dhe Siguri Ekonomike (ANLSEK), Mars, 2020, <https://www.investopedia.com/government-stimulus-efforts-to-fight-the-covid-19-crisis-4799723#italy>

<sup>28</sup> Qeveria e Francës, Portali për Ekonomi, Financa, Veprim dhe Llogaritë publike, Prill, 2020, <https://www.economie.gouv.fr/coronavirus-soutien-entreprises#>

<sup>29</sup> Ibid

Në mënyrë që të ju dal në ndihmë edhe më shumë bizneseve gjatë kësaj rënie ekonomike, shteti do të ofrojë mundësinë e shtyrjes së pagesave të qirave, energjisë elektrike, ujit dhe gazit, si dhe kontributeve të sigurimeve sociale dhe pensione.

Bizneset mund të kërkojnë që të shtynë pagesat deri në tre muaj.<sup>29</sup> 45 miliardë euro të mbetura do të përdoren si plan i veçantë stimulues, për të mbuluar kontributet e sigurimeve sociale, për të shtyrë pagesat e tatimeve të korporatave dhe për të mbështetur njerëzit që janë përkohësisht të papunë, puna e të cilëve është pezulluar për shkak të virusit.<sup>30</sup>

### REAGIMI I INSTITUCIONEVE NDËRKOMBËTARE FINANCIARE NDAJ KRIZËS

Institucionet ndërkombëtare financiare kanë pohuar se COVID-19 është një nga kërcënimet më të mëdha ekonomike të kohës moderne, pasojat e së cilës janë të mëdha.

Prandaj, këto institucione janë mobilizuar të përdorin burimet e tyre për të mbështetur ekonominë botërore dhe parandaluar përshkallëzimet e mundshme. Duhet theksuar se deri më tani, reagimi ka qenë jo mirë i koordinuar, prandaj nevojitet që menjëherë të zgjerohet bashkëpunimi dhe koordinimi strategjik midis vendeve dhe organizatave ndërkombëtare për të ndihmuar ekonominë botërore dhe kompanitë të cilat janë ndikuar keq në treg.

**Banka Botërore (BB) dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare (KNF)**, shpалosën planin e tyre emergjent, që kap vlerën totale prej 14 miliardë dollarë. IFC, anëtare kjo e Grupit të Bankës Botërore, do të rrisë disponueshmërinë financiare deri në 8 miliardë dollarë si pjesë e pakos 14 miliardë dollarësh, ku 6 miliardë dollarë u ndanë më parë. Me këto synohet të mbështeten kompanitë private dhe punonjësit e tyre të cilët janë dëmtuar nga rënia ekonomike.<sup>31</sup>

<sup>30</sup> RFI, Franca premtion 45 miliardë euro që të i ruaj kompanitë që janë dëmtuar nga koronavirusi, Mars, 2020, <http://www.rfi.fr/en/france/20200318-france-promises-45-billion-euros-to-save-companies-hit-by-coronavirus-economy-nationalisation-lockdown-covid-19>

<sup>31</sup> Banka Botërore, Grupi i Bankës Botërore rrit përkrahjen ndaj luftimit të COVID-19 në 14 miliardë dollarë për të ju ndihmuar vendeve të ruajnë ekonominë dhe vendet e punës, Mars, 2020,

Sidoqoftë, ndihma e BB-së do të përdoret kryesisht për qëllime të shëndetit publik, ndërsa ndihma për sigurinë socio-ekonomike është e rëndësishme dytësore. Nuk është e qartë se sa do të ndahen për çështjet ekonomike.

**Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)**, pasi deklaroi se bota ka hyrë në recesion, shprehën gatishmërinë të përshpejtojë rimëkëmbjen ekonomike botërore. FMN deklaroi se disa vende tashmë po kërkojnë përkrahje financiare, dhe se ata janë të gatshëm të përdorin 1 trilion dollarë të tyre për të mbështetur vendet anëtare.<sup>32</sup>

**Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)**, ka reaguar me shpejtësi dhe ka ofruar ndihmë për të lehtësuar punën e kompanive dhe atë të sektorit privat në përgjithësi, në vendet ku operon BERZH-i. BERZH-i prezantoi të ashtuquajturën "Pakoja e Solidaritetit", që kap shumën prej 1 miliardë eurosh. Masat e planifikuara do të përfshijnë zgjerim të financave për tregti dhe sigurimin e mjeteve financiare afatshkurtra deri në dy vjet përmes institucioneve financiare, posaçërisht në mbështetje të NVM-ve. BERZH-i është ende në fazën e ristrukturimit të kredive.<sup>33</sup>

## PËRFUNDIMI DHE HAPAT E MËTUTJESHËM

Ky virusi i rrezikshëm ka shkaktuar tronditje si asnjë më parë. Megjithatë niveli i shtrirjes dhe dëmi ekonomik i shkaktuar nga koronavirusi ende nuk mund të vlerësohet, amullia pothuajse total ekonomike ka krijuar sfida të pashembullta dhe pasiguri ekonomike. Prandaj, për të luftuar pasojat ekonomike, shtetet e ndryshme kanë reaguar përdorur qasje të njëjta duke vendosur masa të rrepta dhe kanë prezantuar plane ekonomike bindëse, ashtu siç u shpjeguan më lart.

Në mes të paparashikueshmërisë absolute në atë se sa do të zgjasë pandemia COVID-19, masat e përkohshme dhe injektimet fiskale të ndërmarra nga ekonomitë e zhvilluara janë më se të mirëpritura. Megjithatë, parakusht për të nxitur rimëkëmbje ekonomike botërore në periudhën pas pandemisë, është të merren veprime të koordinuara dhe të qëndrueshme.

---

<https://www.worldbank.org/en/news/press-release/2020/03/17/world-bank-group-increases-covid-19-response-to-14-billion-to-help-sustain-economies-protect-jobs>

<sup>32</sup> FMN, Deklaratë rreth COVID-19, 2020 Mars, 2020, <https://www.imf.org/en/News/Articles/2020/03/27/pr201>

Shtetet duhet të sigurojnë menaxhim efektiv të krizës në fjalë dhe ta sjellin ekonominë përsëri në rritje përmes një koordinimi dhe mobilizimi të zgjeruar në nivel ndërkombëtar.

[14-joint-statement-by-the-chair-of-imfc-and-the-managing-director-of-the-imf](https://www.ebrd.com/news/2020/ebd-unveils-1-billion-emergency-coronavirus-financing-package.html)

<sup>33</sup> BERZH, BERZH prezanton një pako financiare emergjente prej 1 miliardë eurosh ndaj koronavirusit, Mars, 2020, <https://www.ebrd.com/news/2020/ebd-unveils-1-billion-emergency-coronavirus-financing-package.html>

## LISTA E SHKURTESAVE

**OEAK** – Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë

**ANLSEK** – COVID19 Akti për Ndihmë, Lehtësim dhe Siguri Ekonomike

**BERZH** – Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

**KNF** – Korporata Ndërkombëtare Financiare

**FMN** – Fondi Monetar Ndërkombëtar -

**KfW** – Kreditanstalt für Wiederaufbau

**NVM** – Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

**OBZHK** – Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

**NVM** – Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

**WBG** – Grupi i Bankës Botërore

## REFERENCAT

OBZHK, Vlerësimi i Përkohshëm Ekonomik, Koronavirusi: Ekonomia botërore në rrezik, 2020

OBZHK, Vlerësimi i ndikimit fillestar të masave të kontrollit ndaj COVID-19 në aktivitetin ekonomik, 2020

FMN, Deklaratë për emergjencën e koronavirusit, 2020

Foley & Lardner LLP, Jim Chappelow, COVID-19 Akti për Ndihmë, Lehtësim dhe Siguri Ekonomike (ANLSEK), Mars, 2020

RFI, Franca premtion 45 miliardë euro që të i ruaj kompanitë që janë dëmtuar nga koronavirusi, Mars, 2020

Banka Botërore, Grupi i Bankës Botërore rrit përkrahjen ndaj luftimit të COVID-19 në 14 miliardë dollarë për të ju ndihmuar vendeve të ruajnë ekonomitë dhe vendet e punës, Mars, 2020

Fondi Monetar Ndërkombëtar, Deklaratë për COVID-19, Mars, 2020

Fondacioni për Taksa, Planet për Lehtësim Ekonomik gjatë shpërthimit të COVID-19, Mars, 2020

BERZH, BERZH prezanton pako financiare emergjente prej 1 miliardë eurosh ndaj koronavirusit, Mars, 2020

CBC, Trudeau prezantoi 82 miliardë dollar kanadez për pakon emergjente ndaj COVID-19, Mars, 2020

## FAQET ZYRTARE TË QEVERIVE

Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, COVID-19: Mbështetje për bizneset

Qeveria e Kanadasë, Ndihmë për Bizneset

Qeveria e Gjermanisë, Ministria e Financave të Gjermanisë Federale, Mburoja Mbrojtëse ndaj virusit korona.

Qeveria Zvicerane, Këshilli Federal, Masat kundër Koronavirusit

Qeveria e Francës, Portali për Ekonomi, Financa, Veprim dhe Llogaritë publike